

# Ditari Naturës



Nr. 77 Viti i shtatë i botimit Tetor 2019

Në këtë numër do të gjeni:

- Aksioni për Bunën - mbyllen thirrjet për propozime
- Blue Land Project
- Prezantohet faza e parë e zbatimit të Projektit ACAP
- INCA prezanton projektet në Qarkun e Vlorës
- Speciet invazive në detin Mesdhe
- Coast Day - Shqipëria Feston Ditën e Bregdetit Mesdhetar 2019
- Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune-Vain-Tale
- Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm në Bashkinë Përmet / nga Milieukontakt Shqipëri
- ...pak histori...
- Njoftime

## Aksioni për Bunën, mbyllen thirrjet për propozime

Partnerët e projektit "Mbrojta e Deltës së Bunës", IUCN, PAP/RAC, GWP-Med, Tour du Valat dhe INCA,

në bashkëpunim me AKZM dhe AdRZM Shkodër, kanë nisur nga zbatimi komponentin e programit të Granteve të Vogla, si pjesë e rëndësishme e këtij projekti, të financuar nga Fondacioni MAVA. Në këtë kontekst iu bë thirrje të gjithë të *Vijon në faqe 2*



Vijon nga faqe 1 interesuareve dhe banorëve pranë Peizazhit të Mbrojtur të Lumit Buna Velipojë për të dorëzuar idetë e tyre për financimin e projekteve që do



(projektet mund të propozojnë zhvillimin e shtigjeve tematike eko-miqësore për ecje, promovimin e habitateve dhe specieve më të rëndësishme të zonës, zhvillimin e ofertave të qëndrueshme të eko-turizmit, përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave ose aktivitetet edukative, ndër të tjera); dhe

- Peshkimi i qëndrueshëm (aktivitetet e mundshme mund të përfshijnë krijimin e fermave eko-miqësore të peshkut; mbështetjen e objekteve të qëndrueshme për kultivimin e peshkut ose aktivitete tradicionale dhe eko-miqësore të peshkimit).

të jenë të dobishme për zhvillimin socio-ekonomik dhe restaurimin e ekosistemit të kësaj zonë.

Qëllimi përfundimtar i Thirrjes është të kontribuojë në ruajtjen afatgjatë të specieve dhe habitateve në këtë zonë të mbrojtur, duke mbështetur aksione konkrete në terren. Thirrja ishte e hapur nga 21 Gusht 2019 dhe u mbyll më 23 Shtator 2019.

Idetë duhet të lidheshin me një (ose disa) nga prioritetet tematike të identifikuara:



Projektet duhet të zgjasin minimum 3 dhe maksimum 8 muaj, dhe mundësisht të përfshijnë komunitetet lokale dhe të synojnë ruajtjen e vlerave ekologjike dhe kulturore të Peizazhit të Mbrojtur të Lumit Buna-Velipojë, duke mundësuar përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve ekosistemike.

Për të lehtësuar procesin dhe për të inkurajuar komunitetin lokal të aplikonte, partnerët e projektit organizuan një seri takimesh me përfaqësues komuniteti nga Bashkia Shkodër, njësitë administrative, Ana e Malit, Dajç, Velipojë, Bërdicë, Bushat, Balldren i Ri.

- Restaurimi i habitatit bregdetar (aktivitetet e mundshme mund të përfshijnë pyllëzimin e pyjeve të lumenjve, të degjeneruara dhe të fragmentuara; restaurimin e zonave të dunave të rërës ose habitatet e tjera me rëndësi ose inventarin e zonave / habitateve bregdetare të pasura dhe të rrezikuara në kuptimin e biodiversitetit);

- Skemat stimuluese agro-mjedisore (si një shembull mund të përqëndrohen në kontejnerët miqësorë me mjedisin për plehurat organike; mbrojtjen e habitateve brenda tokës bujqësore; përmirësimin e sistemeve të ujitjes; kultivimin dhe korrjen e qëndrueshme të bimëve mjekësore vendase; përmirësimin e cilësisë së ujit ose aktivitetet edukative);

- Turizmi i qëndrueshëm dhe zhvillimi i infrastrukturës



## Blue Land Project

Tiranë - 12 Shtator 2019 - U mbajt në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Rishikimi i Parë afat mesem i Blue Land Project.



Qëllimi i këtij takimi ishte rishikimi i progresit të deri tanishëm të projektit si dhe objektivat për të ardhem.

Në takim morën pjesë të gjithë partnerët e projektit,

Sekretariati i Përbashkët si dhe përfaqësues të FLC Albania



## Prezantohet faza e parë e zbatimit të Projektit ACAP



Aksione  
Komunitare për  
Zonat e  
Mbrojtura



AGENZIA ITALIANA  
PER LA COOPERAZIONE  
ALLO SVILUPPO



Vlorë 24 shtator 2019 - U zhvillua në mjediset e Konsullatës Italiane në Vlorë prezantimi i rezultateve të arritura gjatë fazës së parë të zbatimit të Projektit ACAP (Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura) si dhe për

vlerësoi iniciativat e ndërmarra nga projekti ACAP në tre komponentët e zbatimit të tij si dhe shprehu entuziazmin e saj që iniciativa të tilla të ndërmerren edhe në të ardhmen.

Në këtë prezantim është vlerësuar bashkëpunimi i ngushtë midis partnerëve dhe mbi të gjitha me komunitetin me të cilin projekti bashkëpunon në çdo moment të zbatimit të tij. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të ndihmojë në ruajtjen e zonave të mbrojtura në Shqipëri.

planet për vijueshmëri të tij.

Konsullia e Italisë në Vlorë znj Micheli i uroi mirëseardhjen të pranishmeve. Në fjalën e saj ajo

INCA prezantoi komponentin e edukimit mjedisor me fokus Zonat e Mbrojtura në zonat pilote, Përmet, Vlorë dhe Berat.



## INCA prezanton projektet në Qarkun e Vlorës

**26 Shtator 2019** - Prefekti i Qarkut Vlorë ka zhvilluar mbledhjen e 2-të të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura të Gjirit të Vlorës.

Në këtë takim INCA prezantoi projektet, arritjet dhe objektivat për të ardhmen, që po zhvillon në Vlorë dhe në Zonat e Mbrojtura të Qarkut të Vlorës.

Në këtë mbledhje gjithashtu u bë prezantimi i aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës 6-mujore të punës së AdZM Vlorë dhe adresimin e problematikave të hasura gjatë sezonin turistik, me fokus në:

1. Hartimin e një plani masash të përbashkët për kontrollin e PKD Karaburun Sazan.

2. Hartimin e Kodit të sjelljes së varkave turistike në PKD.

3. Njohjen me propozimet për rishikimin e planit të menaxhimit të PM Vjosë Nartë, në kuadër të ekspertizës së projektit ACAP.



## Speciet invazive në detin Mesdhe

Më datë 27 Shtator 2019, një webinar i ri u zhvillua online si pjesë e projektit NEMO, ku u bashkuan edhe përfaqësues nga komunitetet të cilat shtrihen përgjatë oqeanit Indian. Ky takim u bë midis përfaqësuesve të vendeve mesdhetare: Tunizisë, Italisë, Marokut, Libanit si edhe nga Somalia dhe Kenia. Duke qenë se vetë projekti lidhet drejtpërdrejtë me peshkatarët, të ftuar edhe këtë herë për t'ju bashkangjitur këtij ëbinar-I ishin peshkatarët që janë pjesë e Shoqatës së Peshkatarëve të Përgjegjshëm.



Tema e këtij takimi lidhej kryesisht me specie invazive detare të vëna re kohët e fundit nga vetë peshkatarët dhe ndikimi që ato kanë sjellë në komunitetin aty afër. Jo më kot këtij webinar i u bashkuan edhe 2 vendet

afër oqeanit Indian, duke qenë se pjesa më e madhe e specieve të cilat shihen si invazive për detin Mesdhe e kanë prejardhjen e tyre nga oqeani Indian, ku ato janë edhe specie vendase.

Speciet invazive quhen speciet jo-indigjene që shpesh shkojnë në vendet e specieve vendase për burime ose habitate, duke ndryshuar strukturën e komunitetit dhe potencialisht duke i çuar ato në zhdukje. Specie të tilla mund të arrijnë në zona të reja përmes migrimit natyror, por ato shpesh paraqiten nga aktivitetet njerëzore dhe janë një nxitës kryesor i humbjes së biodiversitetit. Ato mund të ndikojnë në përbërjen kimike të ujit, disponueshmërinë e burimeve dhe madje edhe të ndryshojnë rrjetin e ushqimit. Disa nga karakteristikat tipike të këtyre specieve janë: gamë e gjerë e tolerancës ekologjike; shkallë e shpejtë e rritjes së individëve; të shpërndara lehtësisht në lokalitete të reja; rritje e shpejtë e popullsisë. Deti Mesdhe është mjaft i prekur nga specie invazive të cilat mund të vijnë edhe në mënyrë natyrore nëpërmjet kalimit të ujërave, për shkak të krijimit të kushteve të përshtatshme të rritjes dhe zhvillimit të këtyre specieve edhe në vende të tjera, e lidhur kjo edhe me një nga faktorët më të mëdhenj që vihet re kohët e fundit sic janë ndryshimet klimatike që kanë ndikuar në rritjen e temperaturës së ujit etj. Nëpërmjet këtij webinar i diskutua që *Vijon në faqe 5*

Vijon nga faqe 4 disa faktorë të tjerë të cilat ndikojnë në përhapjen e këtyre specieve janë edhe anijet e papastruara për një kohë të gjatë dhe që ndërmarrin rrugë të gjata, tregëtia si dhe zhvillimi i akuakulturës me specie jo-vendase.



Për të gjitha vendet e Mesdheut një ndër specie më të përhapura që shihet pothuajse kudo është pikërisht gaforrja blu *Callinectes sapidus*, vendase në Atlantikun Perëndimor, kryesisht në brigjet lindore të SHBA-ve dhe në Gjirin e Meksikës. Nëpërmjet kanalit të Suezit ajo u fut në detin Mesdhe duke gjetur kushtet e përshtatshme, për të ndikuar më pas në popullsinë e gaforres vendase. Gaforrja blu pavarërisht se është mëse e përhapur në ujëra të cekëta si në ligatina, gjendet po ashtu edhe në ujëra të thella detare, duke sjellë kështu probleme të mëdha te peshkatarët, duke shkatërruar rrjetat të tyre. Është mjaft e vështirë kontrolli i tyre dhe zvogëlimi i popullsisë së tyre, prandaj një mënyrë e propozuar nëpërmjet këtij webinarit ishte vetëm promovimi sa më shumë i këtij lloji, për vlerat ushqyese që ai ka. Në Shqipëri, Shoqata e Peshkatarëve të Përgjegjshëm në



bashkëpunim edhe me Administratën Rajonale të Zonave të mbrojtura të Vlorës janë duke zbatuar një projekt i cili konsiston pikërisht në promovimin sa më shumë të kësaj gaforreje, me qëllim kthimin e vëmendjes së komuniteteve detare në konsumimin sa më shumë të saj, duke qenë se në gjendje natyrore nuk ka asnjë grabitqarë të saj, si rezultat i përmasave të mëdha në formën e rritur.

Po ashtu, një ndër llojet detare që është venë re nga peshkatarët e vendeve të ndryshme, i diskutuar në këtë webinar, është edhe *Lagocephalus sceleratus*, një lloj peshku mjaft i rrezikshëm edhe për njeriun, ardhur kryesisht nga oqeani Indian. Ky peshk përmban një sasi të madhe të tetrodotoxinës, që krijohet si rezultat i bakterieve me të cilat ushqehet me përmbajtje të toksinave të shumta. Kjo është një mënyrë mbrojtje e tyre nga grabitqarët, për këtë arsye bëhet mjaft i rrezikshëm për komunitetet afër detit, të cilat bien ndesh me këtë peshk që mund të shkaktojë dëme të mëdha në shëndet vetëm nëpërmjet



prekjes së lëkurës së tij.


Veçantia e këtij webinar qëndroi pikërisht në përfshirjen edhe të komuniteteve afër oqeanit Indian, përfaqësuesit e të cilëve folën gjatë lidhur me speciet tipike të tyre, disa prej të cilave mjaft të rrezikshme dhe jo të përhapura në detin Mesdhe. Po ashtu u diskutuan edhe një sërë temash mjaft të prekshme në jetën e përditshme, siç është ndotja e detit Mesdhe si dhe gjuetia e jashtëligjshme, që vazhdojnë të mbeten problemi kryesor që ndikon drejtpërsëdrejtë në popullatën e peshqve, për pasojë edhe në komunitetet të cilat e kanë jetën të lidhur me burimet që vijnë nga deti.

## Coast Day - Shqipëria Feston Ditën e Bregdetit Mesdhetar 2019

### Shqipëria Feston Ditën e Bregdetit Mesdhetar 2019 Bregdeti dhe ligatinat tona kanë nevojë për ne!

Ndryshimi i klimës po kërcënon ashpër bregdetin e Mesdheut - niveli i detit rritet dhe uji po ngrohet ndërsa ndryshimi i modeleve të stuhisë ndikon në jetën e më shumë se një të tretës së popullsisë së rajonit - rreth 180 milion njerëz. Bregdeti Shqiptar nuk bën përjashtim.

Çdo vit, vendet mesdhetare festojnë "Ditën e Bregdetit" për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e zonave bregdetare dhe mënyrat se si ato kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm. Sot në Peizazhin e Mbrojtur të Lumit Buna Velipojë, Shqipëria po bashkohet me këto festime për të promovuar ligatinat bregdetare si burim të jetës - ato sigurojnë ushqim,



ujë të pastër dhe na mbrojnë nga përmbytjet, përveç se sigurojnë dhe shtëpi për specie të shumta. Aktivitete të ndryshme formuan një program të pasur, nga pastrimi i zonës së mbrojtur dhe një garë me biçikleta, në një konkurs fotografish dhe një panair tradicional me gatimet rajonale, artet dhe zakonet lokale.

Shqipëria është një vend i pasur me ligatina, laguna, liqene (artificiale dhe natyrore) lumenjtë dhe kënetat, ujëra të kripur dhe të ëmbla, janë të bollshme. Ka katër ligatina Ramsar me rëndësi kombëtare dhe

ndërkombetare. Lumi Buna dhe Liqeni i Shkodrës, Liqenet e Prespës, Liqeni i Butrintit dhe Divjakë Karavasta, që kanë biodiversitetin më të pasur.



Ligatinat e Velipojes janë gjithashtu të rëndësishme për zogjtë migratorë, siç janë Herons (Fam. Ardeidae), Rosa (Aserids) dhe lajmëtarë të shumë specieve të ndryshme.

Festa u organizua nga partnerët e projektit Living Buna me mbështetjen e AKZM dhe AdRZM Shkodër. Ngjarjet e Ditës së Bregut gjithashtu dhe si pjesë e fushatës OFFYourMap, janë organizuar në disa vende mesdhetare. Festimi rajonal u mbajt në Ayia Napa të Qipros dhe u pasua nga aktivitetet në Sardenjë në Itali, laguna Ghar el Melh në Tunizi dhe plazhi i gjatë i Ulqinit në Mal të Zi.

Për më shumë informacione, ju lutemi kontaktoni: Aleksandra Nikodinovic, Oficere Komunikimi IUCN ECARO [Aleksandra.Nikodinovic@iucn.org](mailto:Aleksandra.Nikodinovic@iucn.org)

Mësoni më shumë rreth projektit Living Buna:

<http://livingbuna.org/>

Vizitoni faqen zyrtare të Ditës së Bregdetit Mesdhetar: <http://www.coastday.org/>

Bashkohuni në fushatën "OFFYourMap" për ligatinat bregdetare në Mesdhe të udhëhequr nga MedWet: <http://offyourmap.org/>



## Promovimi i përdorimit qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune - Vain - Tale

Zona e mbrojtur Kune Vain Tale dhe menaxhimi i saj. Klubi Ekologjik Lezhë, në kuadër të projektit "Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri"/"Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune - Vain - Tale" financuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur nga INCA, me datën 30.09. dhe 1.10.2019 zhvilloj trajnimin: "Njohja e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur Kune - Vain - Tale dhe çështjet që lidhen me respektimin e zbatimin e këtij plani". Nga trajnuesit J.Gjini, A.Loçi e K. Toni u aktiviteti u fokusua në temat:

- Plani i menaxhimit të zonës Kune-Vain-Tale objektivat, zonimi dhe plani i veprimit. Rishikimi i planit të menaxhimit të zonës Kune - Vain - Tale si një kërkesë e domosdoshme. Planet e zhvillimit të Bashkisë së Lezhës dhe zonat e mbrojtura.
- Detyrat e stafit AdZM dhe zbatimi i kërkesave të planit të menaxhimit. Detyrat e Komitetit të Menaxhimit.
- Përgjegjësitë ligjore e detyrat në nivel lokal për çështjet e mjedisit e të zonave të mbrojtura Pjesmarrësit u njohën në detaje me planin e menaxhimit të KVT, sa ky plan ka shërbyer në ruajtjen dhe mbrojtja e integritetit të peizazheve, habitateve dhe biodiversitetit të një ekosistemit mesdhetar ligatinor e të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të këtij ekosistemi. Po ashtu dhe trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e kërkesave të planit të menaxhimit nga stafi i AdZM dhe detyrat e

Komitetit të Menaxhimit, planet zhvillimore të bashkisë në lidhje me zonat e mbrojtura si dhe përgjegjësit ligjore e detyrat në nivel lokal për çështjet e mjedisit e të zonave të mbrojtura e lartësor formatin e aktivitetit sipas qëllimit të synuar. Vizita në terren konkretizoi e inicioi diskutime e replikime të mjaft çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e vlerave kesaj trashëgimie natyrore të spikatur.



Një nga konkluzionet e trajnimit ishte dhe argumentimi i çështjeve që lidhen me domosdoshmërinë urgjente të rishikimit të thelluar të planit të menaxhimit nga ku veçojmë:

- Ndryshimet e theksuara fizike të Z.M. KVT të ndikuar

- nga faktorë natyror e antropogjen.
  - Dalja e Ligjit të ri për Z. M. (Ligji nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura") zhvillon një nivel të ri kërkesash në menaxhimin e zonave të mbrojtura .
  - Përfundimi i afatit për rishikim i Planit egzistues të Menaxhimit për zonën.
  - Tejkalimi i parashikimeve të efekteve të ndryshime klimatike mbi zonën e mbrojtur.
  - Mos kryerja e rishikimeve periodike të Planit të Menaxhimit (1-5 vjeçare).
  - Ndryshime të stafit të administrimit të Z.M. Kune Vain Tale, të përgjegjësitë e detyrave në kontekste të reja politike.
  - Zbatimi i projekteve në Z.M. të paparashikuara në P.M. dhe mungesa e zbatimit të projekteve me prioritet të parashikuara.
  - Ndryshimet e theksuara në zonat bufer.
- Ky trajnim me një pjesmarrje të gjërë të aktorëve të intersuar ndikoi në aftësimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në drejtim të mbrojtjes e përmirësimit të vlerave natyrore të zonës si dhe të rritjen e rolit të tyre për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të kësaj zone.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e zbatuesit të projektit dhe nuk reflekton pikpamjet e Bashkimit Evropian

## Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm në Bashkinë Përmet

nga *Milieukontakt*

Shoqata "Vjosa Eksplorier" në bashkëpunim me Shoqatën "Milieukontakt" në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor - ReLOaD që mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), kanë filluar zbatimin e projektit "Iniciativa për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Bashkinë Përmet".

"Vjosa Explorer" e krijuar në fillimet e vitit 2018, nga një grup personash të apasionuar pas natyrës, nxitur nga dëshira për të mbrojtur mjedisin, vlerat dhe trashëgiminë historike, kulturore e të traditës së trevës si mundësi e rëndësishme dhe reale për zhvillimin e turizmit alternativ në Përmet.

Milieukontakt Shqipëri ka më shumë se 20 vite eksperiencë me organizatat e shoqërisë civile në fushën e mjedisit, natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm si dhe me autoritetet vendore që mbulojnë këto çështje.

Bashkia Përmet ka mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit, pasi ka një pasuri të lartë resurcesh natyrore, kulturore, historike dhe të traditës..

Zona e Përmetit dallohet për vlerat e saj historiko-kulturore, natyrore dhe ato gastronomike. Këto karakteristika të ndërthurura me njëra-tjetrën, përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit turistik si një nga dy sektorët kryesorë, përfshirë edhe sektorin bujqësor, ku kjo zonë mund të zhvillohet ekonomikisht në mënyrë të qëndrueshme.

Shfrytëzimi i potencialeve të zonës, me një vëmendje të veçantë kundrejt ruajtjes së natyrës dhe mjedisit si dhe tejçimin e vlerave historike, kulturore dhe ato të traditës drejton zonën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo qasje do të ndikojë në rritjen e cilësisë dhe sasisë së shërbimeve turistike e për rrjedhojë, rritjen e numrit të turistëve dhe vizitorëve vendas dhe të huaj.

Si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm mes dy organizatave do të mundësohet realizimi i këtij projekti, i cili synon zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Bashkinë Përmet si një nga sektorët potencial për zhvillimin ekonomik, uljen e nivelit të papunësisë dhe rritjen e cilësisë së jetës së banorëve të kësaj treve. Gjatë projektit do të përmirësohet infrastruktura e informacionit turistik dhe promovimi i zonës nëpërmjet realizimit të hartave me informacionin e plotë të destinacioneve turistike në Bashkinë Përmet, vendosja e tabelave me informacionin turistik, realizimi në grafikë i Simbolit të Qytetit, realizimi i albumit "Pasaporta e Qytetit Përmet" broshura promovuse.

Gjithashtu në kuadër të projektit do të organizohen aktivitete për edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjëve në ruajtjen e mjedisit dhe natyrës, si elementë të rëndësishëm të potencialit turistik e për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.





## ...PAK HISTORI...

## ...5 vjet më parë ...

Më 13.10.2014, inagurohet zyrtarisht, në Korçë, Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë (RNBOB), pas një procesi të gjatë me aktorët më të rëndësishëm në rajon. Këshilli Koordinativ Ndërkombëtar (ICC) i Programit "Njeriu dhe Biosfera" të UNESCO ka miratuar nominimin e RNBOB në sesionin e 26 të mbajtur në Joenköping, Suedi, më 11.6.2014.

Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë, përfshin basenin e liqenit të Ohrit dhe basenin e të dy liqeneve të Prespës, që lidhen me të. Sipërfaqja e rezervës në pjesën shqiptare e maqedonase të basenit të Ohrit dhe nën-baseneve të liqeneve të Prespës është 446,244.52 ha. Kjo rezervë biosfere ndërtohet mbi tre shtylla që kanë të njëjtën rëndësi:

- Konservimi
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Shkenca, edukimi dhe ndërgjegjësimi (logjistika)

Në Rezervën Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë gjenden 454,000 banorë që jetojnë në 23 komuna e bashki në pjesën shqiptare dhe në gjashtë bashki në pjesën maqedonase. E gjithë zona karakterizohet nga një biodiversitet i pasur me specie të rralla e të rrezikuara në nivel global. Liqenet e Ohrit dhe Prespës, për shkak të gjenezës historike, kanë në gjirin e tyre specie të shumta endemike të cilat janë unike dhe gjenden vetëm në ekosistemin ujor dhe në ekosistemet tokësore për rreth liqeneve. Për këtë arsye në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar u krijuan parqet kombëtarë për ruajtjen e këtyre vlerave. Parqet Kombëtarë të Galicicës dhe Pelisterit në Maqedoni dhe Parku Kombëtar i Prespës në Shqipëri përfaqësojnë

funkcionin e konservimit të Rezervës së Biosferës. Në zonën qendrore të rezervës janë përfshirë rreth 14,000 ha ku ndalohet rreptësisht zhvillimi i çfarëdo aktiviteti njerëzor.

Zonat qendrore rrethohen nga një zonë buferike prej 140,429.27 ha në të cilën lejohen ato përdorime të burimeve natyrore që përforcojnë qëllimet e konservimit të zonës qendrore. Zona buferike rrethohet nga zona e tranzicionit me sipërfaqe 291,426.01 ha, në të cilën përdorimi i burimeve natyrore është subjekt i qëndrueshmërisë.

Objektivi qendror në krejt Rezervën Ndërkufitare të Biosferës është zhvillimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në dobi të banorëve lokalë. Meqenëse rajoni në fjalë ka qenë i populluar prej më se 7000 vjet më parë, del nevoja që të rizbulohen njohuritë e mëparshme mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ekzistuese dhe të kombinohen me mjetet dhe masat moderne për përmirësimin e jetesës të banorëve vendas. Kjo detyrë adresohet sektorit shkencor, i cili në të dy vendet bregliqenore përfaqësohet nga universitete dhe institucione kërkimore të ndryshme.

Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Ohër Prespë do të administrohet nga Komiteti i Menaxhimit të Basenit të Ohrit (OWMC), një institucion i krijuar në kuadrin e një marrëveshje dypalëshe nga të dy vendet bregliqenore, e nënshkruar në vitin 2004 dhe e ratifikuar nga parlamentet e të dy vendeve. OWMC mbështetet nga Sekretariati i Përbashkët me zyra në Pogradec dhe Ohër. Sekretariati i përbashkët do të jetë njësi që do të organizojë bashkëpunimin brenda kufijve të RNB të re.

## ...11 vjet më parë ...

Miratohet Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për Mbrojtjen e faunës së egër". Ligji ka për qëllim mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e faunës së egër, me synim për të ruajtur llojet, popullatat, habitatet ku ato jetojnë, rrugët e shtegtimin, si dhe për të siguruar kërkesat e tyre për ushqim, strehim dhe shumim.

Fauna e egër në territorin e Republikës së Shqipërisë është pasuri kombëtare, që administrohet dhe mbrohet me ligj, në përputhje edhe me konventat përkatëse ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ligj zbatohet për të gjitha llojet e nënllojet e faunës së egër, përfshirë vezët, foletë, të vegjlit dhe habitatet ku jetojnë të lira, *Vijon në faqe 10*

*Vijon nga faqe 9*

përgjithmonë ose përkohësisht, në mjedise natyrore, tokësore e ujore, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fondi i faunës së egër përbëhet nga tërësia e llojeve të egra, nga popullatat e tyre, si dhe nga habitatet ku ato jetojnë në gjendje të egër.

Mbrojtja e faunës së egër synon:

- a) ruajtjen e rimëkëmbjen e larmisë së llojeve dhe tërësinë e tyre gjenetike;
- b) mbrojtjen e habitateve, të rrugëve të shtegtimitit e të kushteve të shumimit të tyre;
- c) ruajtjen e integritetit të komuniteteve natyrore;
- ç) përdorimin e faunës së egër për qëllime studimore-shkencore, që sigurojnë rigjenerimin e tyre;
- d) rihyrjen e llojeve të faunës, të zhdukura apo të rrezikuara.

Ndër të tjera ligji shtjellon: Mbrojtja e llojeve të kërcënuara dhe endemike; Mbrojtja e habitateve, e rrugëve të shtegtimitit dhe e kushteve të shumimit; Mbrojtja nga efektet negative të ndryshimeve klimatike; Rimëkëmbja e popullatave të llojeve; Masa të veçanta për ruajtjen e shpendëve të egër; Masa shpëtuese; Veprime të ndaluara; Përdorimi i llojeve të faunës së egër, ndalimi i përdorimit të llojeve të mbrojtura, përdorimi i faunës së egër për qëllime shkencore, kulturore dhe edukuese; Mbrojtja e faunës së egër në gjendje robërie; Veprimtaritë për shumimin në gjendje jo të lirë të faunës së egër; Planifikimi dhe vjelja e llojeve të faunës së egër; Rruajtja e numrit të popullatës së llojeve të faunës së egër; Inventarizimi i faunës së egër, vjelja; Monitorimi i faunës së egër; Kontrolli për mbrojtjen e faunës së egër, organet e kontrollit; Sanksionet...

*...12 vjet më parë ...*

...me VKM nr. 687, datë 19.10.2007 ekosistemi natyror "Divjakë-Karavasta" shpallet Park Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar 22.230.2 ha, në të cilin përfshihet edhe pjesa e territorit në administrim të Kavajës (Gosë) dhe Fierit (Libofshë). Gjithashtu, pjesë e PK, u bë dhe laguna e Karavastasë, me sipërfaqe 5000 ha, e cila sipas VKM nr. 102, datë 15.1.1996 kishte

statusin "Rezervat Strikt Natyror".

Njëherazi, ky territorit, si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur, ka dhe statusin e Zonës Ramsar, me VKM nr. 413, datë 22.8.1994.

Në kuadër të bashkëpunimit me JICA për PK "Divjakë-Karavasta" është hartuar edhe Plani i Menaxhimit, i cili është miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit nr.782, datë 30.12.2015.

*...15 vjet më parë ...*

Vendimi i KM nr. 680, datë 22.10.2004 shpalli sistemin ligatinor të VJOSË-NARTË "Peizazh Ujor/Tokësor i Mbrojtur", me sipërfaqe 19738 ha, nga e cila 7225 ha sipërfaqe ligatinore, 1167 ha pyjore, 7798 ha bujqësore, 2985 ha ujore dhe pjesa tjetër urbane e industriale. Në këtë territor u përfshi edhe ish Rezervati i Gjuetisë "Pishë Poro" (Vlorë), me sipërfaqe 1750 ha, i miratuar nga Ministria e Bujqësisë në vitin 1969.

Është për tu theksuar se me këtë VKM dhe sipas Planit të Menaxhimit, për herë të parë, u praktikuar dhe u miratua procesi i zonimit të territorit për zonat e mbrojtura.

PM "Vjosë-Nartë" ka plan menxhimi, i hartuar qysh më Dhjetor 2004, në kuadër të projektit MedWetCoast "Ruajtja e ligatinave dhe e ekosistemeve bregdetare në rajonin e Mesdheut", financuar nga GEF/UNDP. Ky plan nuk u mbështet financiarisht për zbatimin e tij dhe i ka ardhur koha për rishikim...

*...17 vjet më parë ...*

...me VKM nr.531, datë 31.10.2002, territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) shpallet zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës "Për

ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë", me sipërfaqe të përgjithshme 13,500.0 ha. Pjesë e kësaj zone Ramsar janë edhe territoret e përfshira në Parkun Kombëtar të Butrintit.

## Konventat Ndërkombëtare ku Shqipëria është palë

### Konventa e AARHUSIT

**Konventa e AARHUSIT "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"**

U nënshkrua më 25 Qershor 1998, në Aarhus të Danimarkës. Shqipëria është bërë palë e kësaj konvente në bazë të ligjit nr. 8672, datë 26.10.2000. Objektivi i konventës është që të kontribuojmë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij, çdo palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente. Sipas konventës çdo Palë do të marrë masat e nevojshme legislative, rregullatore dhe masa të tjera, duke përfshirë masat për të arritur një përputhje midis klauzolave që zbatohen kushtet e të drejtës së informimit, pjesëmarrjes dhe të drejtës për t'ju drejtuar gjykatës në këtë Konventë, si dhe masat e duhura të zbatimit rigoroz për të krijuar dhe ruajtur një kuadër të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm për zbatimin e klauzolave të kësaj Konvente; të përpiqet të sigurojë që zyrtarët dhe autoritetet të ndihmojnë dhe udhëheqin publikun, kur kërkojnë të informohen për mjedisin, kur kërkojnë lehtësimin e pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve mjedisore dhe kur kërkojnë t'i drejtohen gjykatës për çështjet e mjedisit; të promovojë edukimin mjedisor dhe rritjen e

ndërgjegjësimin mjedisor të publikut, veçanërisht për mënyrën e marrjes së informacionit për mjedisin, të marrjes pjesë në vendimmarrjen dhe të ushtrimit të së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës; të parashikojë masa për njohjen e duhur dhe mbështetjen e shoqatave, organizatave, ose grupeve që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe do të sigurojë që sistemi i vet ligjor kombëtar, të jetë në përputhje me këtë detyrim; Konventa nuk do të kërkojë pakësimin/dobësimin e të drejtave ekzistuese të publikut për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit; të promovojë zbatimin e parimeve të kësaj Konvente në proceset ndërkombëtare të vendimmarrjes për mjedisin dhe brenda kuadrit të organizatave ndërkombëtare në çështjet që lidhen me mjedisin; të sigurojë që personat, të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente nuk do të gjykojnë, persekutohen, ose ngacmohen në çfarë do mënyrë për përfshirjen e tyre. Kjo Klauzolë nuk do të ndikojë autoritetin e gjykatave kombëtare në dhënien e kostove të arsyeshme gjatë procedurave gjyqësore, dhe sipas kësaj Konvente, publiku do të ketë të drejtën për të pasur informacion, do të ketë mundësinë për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe do të ketë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, pa u diskriminuar, për sa i përket nënshtetësisë, kombësisë, vendbanimit dhe në rastin e një personi juridik, pa u diskriminuar për shkak të vendit të tij të regjistrimit ose të qendrës efektive të veprimtarive të tij.





## Njoftime

- 4 Tetor - Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve
- 7 Tetor - Dita Botërore e Habitaveve (e hëna e parë e tetorit)
- 12 Tetor - Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë (e shtuna e dytë e tetorit)
- 13 Tetor - Dita Ndërkombëtare për Pakësimin e Fatkeqësive Natyrore
- 16 Tetor - Dita Botërore e Ushqimit
- 24 Tetor - Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën
- 1 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

## Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.


Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

## Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



## Organizatat Partnerë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA  
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro